



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:241345

Datë: 16.01.2025

Numri i dokumentit: 06717789

AC.nr.2527/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË- në kolegjin e përbërë nga Gjyqtarët Fatmir Baloku-Kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Bujar Dobërdolani- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridiko-civile kontestimore, të paditëses E.P nga Prizreni, të cilin e përfaqëson me autorizim av. N.M nga Prizreni, kundër të paditurës A., “L.– G” me seli në Prizren, me objekt të kontestit anulim i vendimit dhe kthim në vendin e njëjtë të punës, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren– Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2293/21, të datës 31.03.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 15.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditëses E.P nga Prizreni, e ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren– Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2293/21, të datës 31.03.2022.

PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2293/21, i datës 31.03.2022 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.2293/21, i datës 31.03.2022, ka vendosur si në vijim: I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar, kërkesëpadia e paditëses, E.P nga Prizreni, e me të cilën ka kërkuar që të : “ANULOHET Vendimi për sistemimin e të punësuarës në vendin e punës i dt.14.09.2021 i lëshuar nga e paditura, A., ”L- G” me seli në Prizren, dhe të DETYROHET, e paditura, ”L- G” me seli në Prizren, që paditësen t’a kthej në vendin dhe detyrat e punës sipas kontratës së punës së dt.01.02.2018, në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim si dhe që të DETYROHET, e paditura, A., ”L- G” me seli në Prizren, që paditëses, t’ia kompensoj shpenzimet procedurale në shumën prej 415.00 € dhe atë në afatin ligjor prej 7 ditësh pas pranimit të aktgjykimit e nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim”.II. CAKTOHEN shpenzimet procedurale në këtë çështje juridike kontestimore dhe atë në shumën prej 478.00 € (katër qind e shtatëdhjetë e tetë) dhe DETYROHET, paditësja, E.P nga Prizreni, që të paditurës, A., ”L - G’ me seli në Prizren,

t'ia paguaj këto shpenzime procedurale dhe atë në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë paditësja, përmes të autorizuarës të saj, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet si e bazuar apo që aktgjykimi të priset dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

E paditura përmes përgjigjes në ankesë ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar me ankesë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, ekzaminoj aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

Ankesa e paditëses është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja E.P ka ushtruar padi kundër të paditurës A. "L – G" për anulim të vendimit.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2293/2021, të datës 31.03.2022, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar në tërësi, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa në arsyetim mes tjerash ka theksuar se: duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe provat e administruara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar dhe se duke u bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, e njëjta duhet të refuzohet në tërësi si e pa bazë. Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, por edhe deklarimit të vetë palëve ndërgjyqëse, nuk del të jetë kontestues fakti se paditësja tek e paditura në bazë të kontratës së punës (në kohë të pa caktuar) ka qenë në marrëdhënie të punës në pozitën e mësimitdhënëses dhe fakti se e njëjta aktualisht është duke punuar si mësimitdhënëse për lëndët Gjuhë Latine dhe Gjuhë Angleze. Megjithatë kontestuese ka mbetur fakti se vendimi për sistemim e paditëses, a duhet të anulohet ashtu siç ka pretenduar pala paditëse dhe se a duhet e paditura t'a kthej paditësen në vendin e punës. Nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, gjykata erdhi në përfundim se e paditura është e kthyer në vendin e saj të punës si mësimitdhënëse e gjuhës latine dhe gjuhës angleze në bazë të vendimit me nr.të protokollit: ..., të dt.09.11.2021 të Komisionit Disiplinor të të paditurës e cila ka rekomanduar që të anulohet vendimin mbi sistemimin e paditëses në vend tjetër të punës me numër ..., të datës 14.09.2021 dhe shkresës së drejtorit ekzekutiv drejtuar të paditurës që të vazhdoj punën si mësimitdhënëse e gjuhës latine dhe gjuhës angleze. Po ashtu edhe nga orari i shkollës i datës 21.02.2022, u vërtetua se paditësja mësimit do të mbajë në gjuhën latine dhe angleze për klasat e 6-ta dhe 12-ta, ashtu edhe siç është përcaktuar me kontratën e punës të dt.01.02.2018 dhe aneks kontratës të datës 01.04.2019. Gjykata duke analizuar me kujdes kërkesëpadinë e palës paditëse dhe thëniet në padi, ka ardhur në përfundim se në fakt është përmbushur në tërësi kërkesëpadia e paditëses, e njëjta aktualisht është duke punuar si mësimitdhënëse e gjuhës latine dhe gjuhës angleze pranë të paditurës dhe nuk është e nevojshme

kthimi i saj në vend pune përmes mbrojtjes gjyqësore, poashtu edhe vendimi i paditurës për ri sistemim me numër ..., të dt.14.09.2021, është i anuluar me vendimin e komisionit disiplinor të paditurës, nr....., të dt.09.11.2021, ku është rekomanduar drejtori ekzekutiv për anulimin e vendimit në fjalë. Për më shumë, gjatë shqyrtimit kryesor është administruar edhe vendimi nr....., të dt.01.11.2021 të Inspektoratit të punës në Prizren me të cilin vendim është urdhëruar e paditura që t'a zbatoj kontratën e punës të dt.01.02.2018 e lidhur ndërmjet paditëses si punëmarrëse dhe të paditurës si punëdhënëse si dhe zbatimi në aneks kontratës së dt.01.04.2019. Gjykata përfundimisht vlerëson se e paditura, është duke i përmbush në tërësi obligimet që rrjedhin nga kontrata e punës e dt.01.02.2018 dhe aneks kontrata e dt.01.04.2019, sepse paditësja është e obliguar që ti kryej detyrat e punës si mësimdhënëse e gjuhës latine dhe gjuhës angleze në bazë të orarit të mësimit i datës 21.02.2022 me çka konstatohet me të drejtë se kontrata e punës dhe aneks kontrata të lartcekura janë përmbushur dhe se kërkesëpadia e paditëses poashtu është përmbushur në tërësi ashtu siç është precizuar nga e autorizuara e saj gjatë fjalës përfundimtare me shkrim. Gjykata duke marrë për bazë faktin se paditësja, E.P nga Prizreni, është duke i kryer detyrat e punës si mësimdhënëse e gjuhës latine dhe gjuhës angleze sipas kontratës dhe aneks kontratës të lidhur me të paditurën, ndërsa nga kërkesëpadia e paditëses rezulton kërkesa për anulim të vendimit për ri sistemim dhe kthim në vendin e punës sipas kontratës dhe aneks kontratës, gjykata gjen se në rastin konkret paditësja është duke i kryer detyrat e punës sipas kontratës dhe aneks kontratës dhe se kërkesa e paditëses është e përmbushur në tërësi, andaj edhe e njëjta është refuzuar si e pabazuar duke pas parasysh faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor. Gjithashtu, gjykata gjatë administrimit të provave ka bërë edhe administrimin edhe provave tjera të administruara në shqyrtim kryesor, por vlerësoi se të njëjtat nuk janë relevante dhe janë pa ndikim në vendosjen meritorë të kësaj çështje juridike, për faktin se këto vendime përpos që nuk janë përfundimtare, çfarëdo vendimi që do të vendos Inspektorati i Punës në këtë rast, kjo nuk e lidh gjykatën për të vendosur ndryshe në këtë çështje kontestimore pasi që këto vendime, janë të ndara nga pjesa e mbrojtjes gjyqësore që e kërkon paditësja por edhe se organi që iu ofron mbrojtje nga të drejtat e punës nga marrëdhënia e punës së të punësuarve, është gjykata, dhe atë vetëm pas shterimit të mjeteve të brendshme juridike të një punëdhënësi siç është në rastin konkret. Pra, në këtë çështje me të drejtë konstatohet se vendimi të cilin paditësja e kërkon anulimin tashmë është i anuluar dhe kthimi në pozitën e punës të cilën e kërkon paditësja, E.P nga Prizreni, si mësimdhënëse e gjuhës latine dhe gjuhës angleze sipas kontratës së punës dhe kërkesës në padi nga e paditura, A, "L- G" me seli në Prizren veç se bërë është e me rastin e dorëzimit të orarit të mësimit ku figuron qartë se vijimi i mësimit nga paditësja do të bëhet për lëndën e gjuhës latine dhe gjuhës angleze ashtu siç është e përcaktuar edhe me nenin 5 të kontratës së punës së dt.01.02.2018. Vendimi mbi caktimin e shpenzimeve procedurale e që paditësja të detyrohet që të paditurës, t'ia paguaj shpenzimet procedurale, kjo gjykatë e mori, e duke u bazuar në nenit 449, 452 dhe nenit 463 të LPK-së dhe atë për shkak se paditësja, e ka humbur kontestin ndërsa e paditura, e ka bërë specifikimin e shpenzimeve të kërkuara procedurale si dhe i ka kërkuar shpenzimet në shumën prej 478.00 € (katër qindë shtatë dhjetë e tetë) dhe atë për përgjigje në padi e kërkon shumën prej 208,00 euro dhe në emër të dy seancave nga 135,00 euro, për secilën seancë gjyqësore.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e vërtetuar e çështjes, tani për tani nuk pajtohet me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sa i përket aktgjykimit të atakuar pasi që përfundimi i saj nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 të LPK-së për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por edhe me shkelje tjera, të cilat pretendohen me ankesë të paditëses.

Gjykata e Apelit konsideron se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje qenësore nga dispozita e nenit 182.2 pika n) të LPK-së, për shkak se aktgjykimi ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të ekzaminohen, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare dhe se arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar janë kontradiktore me vetveten dhe përmbajtjen e provave të administruara.

Arsyetimi i aktgjykimit është i paqartë dhe kontradiktor, i njëjti më shumë është përshkrim i veprimeve të kryera procedurale, provave të administruara, pa u lëshuar në atë se cilat fakte i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po qe se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.

Si rrjedhojë e kësaj gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë e që si pasojë e kësaj, aktgjykimi i gjykatës së parë është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk pajtohet me përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se paditësja është kthyer në vendin e saj të punës si mësimdhënëse e gjuhës latine dhe angleze në bazë të vendimit me nr të protokollit ..., te datës 09.11.2021, të komisionit disiplinor dhe se gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se është përmbushur kërkesëpadia e palës paditëse, sepse në rastin konkret paditësja ka kërkuar që të anulohet vendimi i datës 14.09.2021, mirëpo gjykata e shkallës së parë këtë e ka refuzuar, duke konstatuar se vendimi është anuluar nga komisioni disiplinor, e që me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se komisioni disiplinor i ka rekomanduar Drejtorit Ekzekutiv "A, L-G" që të anuloj Vendimin për sistemimin e të punësuarës në një vend tjetër të punës, me numër të protokollit ..., i datës 14.09.2021, por, në shkresat e lëndës nuk ekziston provë se Drejtori ekzekutiv ka vepruar në bazë të rekomandimit të komisionit disiplinor.

Meqenëse në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, aktgjykimi i atakuar me ankesë u deshtë që të priset dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Në riprocedurë Gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të vërtetoj faktin se Drejtori Ekzekutiv "A., L-G", a ka vepruar në bazë të rekomandimit të komisionit disiplinor të datës 09.11.2021, dhe varësisht nga kjo, të administroj të gjitha provat, të vlerësoj secilën veç e veç e të gjitha në lidhshmëri reciproke dhe pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor të bie vendim meritore, me të cilin do të vendosë lidhur me kërkesëpadinë e paditëses.

Aktgjykimi të jetë i qartë dhe në pajtim me dispozitat e nenit 160 të LPK-së, dispozitivi i aktgjykimit të përmban vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale. Arsyetimi të përmban kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po qe se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.

Gjykata duhet të tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata të deklarohej edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë më herët gjatë procesit gjyqësor.

Gjykata e shkallës së parë udhëzohet që me rastin e vërtetimit të gjendjes faktike në mënyrë sa më të plotë me rastin e provimit të fakteve të bazohet në dispozitat e nenit 7, 319 dhe 322 të LPK-së.

Gjykata e Apelit shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin relevante për vendosje ndryshe.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika c), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AC.nr.2527/2022 me datë 15.01.2025.

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v